

**ALBULENA PLLANA BREZNICA  
FISNIKE PLLANA**

**ROLI I USHTRIMEVE PËR MËSIMIN E GJUHËS ANGLEZE NË  
SHKOLLAT E MESME TË LARTA TË KOSOVËS**

***Përmbledhje***

*Ndikimi në rritje i gjuhës angleze në kontekstin e globalizimit ka zgjuar interes në gjetjen e teknikave dhe të strategjive më të përshtatshme që kontribuojnë në përvetësimin e saj. Komunikimi ndërmjet popujve të botës tashmë është më i lehtë se më parë si rezultat i ndryshimeve në shkencë dhe në teknologji (përdorimi i internetit dhe telefonave pa kabllo). Njerëzit përpiqen që të mësojnë gjuhë të ndryshme për të komunikuar me popuj të tjerë. Duke qenë një gjuhë e komunikimit ndërkombëtar, anglishtja është një ndër gjuhët për të cilën ka kërkesa të larta, në tërë rruzullin tokësor, për t'u mësuar. Andaj, mësimdhënësit e gjuhës angleze duhet të gjejnë metoda dhe rrugë të reja për të mësuar nxënësit në mënyrë të thjeshtë dhe efektive duke i kushtuar rëndësi modernizimit të metodave e teknikave të mësimdhënies dhe të nxënies ashtu si dhe të materialeve mësimore që përdoren. Ushtrimet gjatë orës së gjuhës angleze në shkolla të mesme të larta duhet të janë në radhë të parë, në sasi e cilësi, e, njëkohësisht duhet të përdoren teknika, tekste mësimore e materiale didaktike bashkëkohore dhe laboratorë të pajisur me mjete konkretizimi.*

***Fjalët çelës:** shkolla e mesme e lartë, gjuha angleze, materialet mësimore, ushtrimet.*

**Hyrje**

Gjuha është sistem, dhe si të gjitha sistemet, ka anën e vet funksionale: *ligjërimin*, që është një veprimtari mjaft specifike, që realizohet në formë gojore dhe librore. Gjithashtu ka anën *marrëse*, që realizohet përmes shkrimit dhe leximit, dhe anën *prodhuese*: të folurit dhe shkrimin.

Të mësuarit e gjuhës angleze është një proces kompleks që përfshin:

- Njohjen e materialit konkret gjuhësor (fonetik, leksikor dhe gramatikor),
- Shprehitë dhe aftësitë në dëgjim dhe të folur, në lexim e shkrim,

- Fushën (tematikën) në të cilën bëhet komunikimi gojor dhe libror. Gjatë angazhimit për mësimin e gjuhës angleze ndeshemi me një mospërputhje midis qëllimit të përvetësimit praktik dhe krijimit të kushteve të domosdoshme për realizimin e tij. Shpesh përvetësimi i materialit gjuhësor identifikohet me zotërimin e gjuhës, me funksionin e saj.

#### **Programet mësimore**

Për të ilustruar këtë analizë, ne do të vendosemi në një nivel të përcaktuar qartë, në orën mësimore të gjuhës angleze, duke sugjeruar *ushtrime* që mund t'u propozojmë nxënësve gjatë fazave të ndryshme të shqyrtuara, duke u nisur nga një tekst i caktuar. Ne, ndërkaq, mendojmë që këto ushtrime mbeten me vlerë për një kohë të gjatë në qoftë se kujdesemi që *konceptimin*, *ritmin* dhe *përparimin* e tyre duke ua përshtatur nivelit të njohurive të nxënësve.

Në kushte normale të organizimit të sotëm të shkollës, në shkollimin e mesëm të lartë në Republikën e Kosovës, faktori kohë duket kryesor në qoftë se mendojmë që mësimdhënësi, për grupe nxënësish dhe për një vit shkollor, ka në dispozicion, mesatarisht, vetëm nja njëqind orë mësimore nga gjuha angleze (tani në bazë të kurrikulës, nxënësit e shkollave të mesme të larta profesionale dhe gjimnazet drejtimi i shkencave të natyrës kanë nga 70 orë (40L+30U) mësimi brenda vitit shkollor, kurse gjimnazet drejtimi i shkencave shoqërore kanë 105 orë (70L+35U) mësimi nga gjuha angleze, normalisht për një organizim të mirë dhe për një realizim të mençur të numrit të veprimtarive të ndryshme. Ora e gjuhës angleze duhet të organizohet si një mekanizëm i përpiktë, me një model bashkëkohorë. Në programet mësimore, ende nuk gjenden kërkesa sasiore dhe cilësore e të përcaktuara saktë për shkathtësitë, në aspektet kryesore të ligjërimit, për etapat e ndryshme të nxënies.

#### **Organizimi i bisedës**

Rregulla themelore është organizimi i bisedës; kur duhet të flasë, kur duhet të heshtë, kur duhet të hyjë në bisedë, kur duhet të flasë qetë dhe qartë; gjuha amtare afirmohet kështu, si pikënisje për qasje në gjuhën angleze. Në mësimdhënien e gjuhës angleze duhen marrë parasysh kompetencat gjuhësore të zhvilluara në gjuhën amtare, të analizës gramatikore dhe metalinguistike. Andaj, qëllimi i mësimin të gjuhës angleze duhet të jetë për të marrë pjesë në situatat e komunikimit. Ndryshe nga gjuha amtare, nxënësit e mësojnë gjuhën angleze me qëllim për të

## Roli i ushtrimeve për mësimin e gjuhës angleze në shkollat...

siguruar një të ardhme për punësim në vende të ndryshme të botës dhe për komunikim.

Procesi i të mësuarit të gjuhës angleze të ndërmjetësohet nga gjuha amtare.

Profesorët e gjuhës angleze në Republikën e Kosovës duhet integruar problematikën e mirëkuptimit reciprok të dy gjuhëve (shqipe dhe angleze) që nënkupton analizën e strategjive të ndërtimit të kuptimeve nga folësit e gjuhës shqipe përballë gjuhës angleze, të panjohur për ta, duke nxjerr në shesh ndryshimin e tyre.

### **Teksti mësimor dhe materiali didaktik**

Shumica e orëve mësimore të gjuhës angleze, çfarëdo që të jetë metoda, teksti mësimor apo materiali didaktik i përdorur, në tërësi, përmbajnë:

- 1) Kontroll të shpejtë të njohurive të fituara i cili, në të shumtën e rasteve, zë vend në fillim të orës mësimore, ç'farë u shërben nxënësve për vënien e tyre në lëvizje apo për përshtatje, porn ë anën tjetër, mësimdhënësit i mundëson vlerësimin e efikasitetit të tij,
- 2) Studim të elementeve të reja gjuhësore, i cili, në përgjithësi, përmban tri faza themelore:
  - a) *Shpjegimin e këtyre elementëve*: formë, përmbajtje dhe marrëdhënia formë-përmbajtje,
  - b) *Ripërdorimin dhe përshtatjen*, d.m.th., njëkohësisht, përdorimin e njohurive të fituara roshatas dhe përfshirjen e menjëhershme të tyre në tërësinë e njohurive tashmë të fituara me qëllim të të shprehurit profesional, sidomos nxënësit e shkollave të mesme të larta profesionale,
  - c) *Ngulitjen e strukturave kryesore gramatikore në kujtesën e nxënësve*.

Mësimdhënësit duhet të planifikojnë *ushtrime* të cilat u përgjigjen këtyre fazave të ndryshme, duke përdorur teknikat bashkëkohore të mësimdhënies që i shkojnë përshtati secilit çast të orës mësimore të gjuhës angleze.

### **Sqarimet në gjuhën angleze**

Në të gjitha rastet, sqarimet në gjuhën angleze duhet të jenë të shkurtëra dhe menjëherë të pasuara nga përdorimi, nga ana e nxënësve, i trajtës së re të mësuar: përsëritje kolektive dhe individuale me radhë, duke u kujdesur mësimdhënësi gjithnjë për cilësinë fonetike të riprodhimit të

modelit të dhënë. Grupi fonetik (njësia fonetike, semantike dhe sintagmatike) paraqet një interes për formimin e automatizmave në gjuhën e folur. Qëllimi është që të arrihet, në mënyrën më të thjeshtë të mundshme, në të kuptuarit e kënaqshëm të përmbajtjes së përgjithshme të njësisë mësimore, në përsëritjen e saktë të secilit grup fonetik dhe në një të mbajtur mend, i cili nxënësve duhet t'u mundësojë që për mrekulli të njohin dialogun ose tekstin e mësuar.

#### **Përdorimi i fjalëve të reja**

Gjatë zhvillimit të orës së gjuhës angleze, do të jetë krejt natyrshëm ripërdorimi i elementeve gjuhësore të cilat posa i kemi mësuar, madje edhe më mire se një përdorim i thjeshtë, një përdorim i këtyre elementeve, d.m.th. futje e sërishme e tyre në përdorim, në kontekste jo shumë të ndryshme nga ai në të cilin janë shpjeguar, por megjithatë mjaft të ngjashme mes vete në mënyrë që elementet e përvetësuara më pare nxënësve t'u kujtohen lehtë.

Ne rekomandojmë që ushtrimet e “përdorimit” të fjalorit, menjëherë pas “shpjegimit” të tij, madje edhe para se t'u qasemi ushtrimeve të ngulitjes tek nxënësit të cilat do të kenë për qëllim që, përmes ndërtimit të fjalive në seri, të nguliten strukturat gramatikore kryesore. Për këtë qëllim duhet ndjekur një ecuri në faza, duke shkuar, sikur në çdo pedagogji të mirëfilltë, prej të thjeshtës kah më e përbëra, në këtë rast prej më artificiales kah më e lira.

#### **Përfundim**

Mungesa e ushtrimeve të përshtatshme për zhvillimin e ligjëritit pasqyrohet në rezultatet e pamjaftueshme që vihen re në përvetësimin e gjuhës angleze nga nxënësit.

Për mësimin e gjuhës angleze në shkollë të mesme të lartë, të folurit dhe leximi zënë vendin kryesor, kurse shkrimi përdoret si mjet ndihmës për përvetësimin e leximit dhe të të folurit. Secili nxënës, domosdoshmërisht, duhet të mësohet me ushtrime adekuate, d.m.th. të folurit me veprime mësimore së foluri, të lexuarit me lexim etj., por pa i kundërvënë ato.

Të folurit është një kombinim i dijeve gjuhësore me aftësinë për t'i përdorur ato në mënyrë krijuese sipas situatës konkrete. Andaj, duhet ndërtuar një sistem ushtrimesh për formimin e mekanizmit të ligjëritit gojor nëpërmjet veprimeve mësimore në të folur, të diktuar nga situata.

Roli i të ushtruarit intensiv dhe i praktikës nuk duhet mohuar. Këto janë ecuri kryesore për formimin e shprehive dhe shkathtësive të të folurit.

Ai duhet të jetë një process aktiv dhe i vetëdijshëm për përvetësimin e dijeve, formimin e shprehive dhe të shkathtësive për komunikim, duke u mbështetur në mënyrë të arsyshme në *gjuhën amtare*, duke kombinuar praktikën me teorinë.

Në përvetësimin e gjuhës angleze, në përgjithësi, nxënësit kanë vështirësi në lidhje me gjuhën amtare. Ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme në lidhje me krahasimin adekuat të të dy gjuhëve, duke hasur gjithmonë në pengesa si përzjerje kohësh të foljeve si dhe i ndërtojnë gabim frazat, sidomos në gjuhën e shkruar. Nxënësit në përgjithësi, kanë për tendencë t'i referohen gjuhës amtare për t'ju afruar gjuhës angleze gjë që pengon mendimin e rrjedhshëm dhe efikas në njërën prej gjuhëve.

Mendojmë se duhet të rritet numri i orëve të ushtrimeve dhe të zgjedhen materiale adekuate, bashkëkohore të kohës, sidomos për shkollat e mesme të larta profesionale.

## BIBLIOGRAFI

- Breznica, A. P. & Pllana, S., *Mësimi i AQS-së (Anglishtja për Qëllime Specifike) në SHMT "Lutfi Musiqi" në Vushtrri*, në Konferenca V Ndërkombëtare "Kërkime gjuhësore", QSA, 15 korrik 2016, Tiranë, 2016.
- Breznica, A. P., *Roli i kulturës në mësimin e gjuhës së huaj*, në Konferenca IV ndërkombëtare "Kërkime gjuhësore", QSA, 10 korrik 2015, Tiranë, 2015.
- MASHT, *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar)*, Prishtinë, gusht 2016.
- MASHT, *Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës (Gjimnazet - klasa X, XI, XII) (e rishikuar)*, Prishtinë, gusht 2016.
- MASHT, *Strategjia kombëtare 2009 – 2013*, Prishtinë, 2009.
- Mehmeti, I., *Shprehjet idiomatike të anglishtes me përbërës foljor në përkthimet letrare në shqipe*, Universiteti i EJL-së, Tetovë, 2008.
- Musai, B., *Psikologji edukimi-zhvillimi, të nxënës, mësimdhënia*, Tiranë 1999.
- Xega, E., *Dimensioni ndërkulturor në mësimdhënien e gjuhës së huaj*, BSH-seria e shkencave shoqërore Universiteti "F. S. Noli", Korçë, Viti XVII i botimit, Nr. 23, Korçë, 2012.